**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

*Qeveria –Vlada-Government*

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / *Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta***

***Ministry of Culture, Youth & Sports***

**Këshilli Kombëtar për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive**

**KOMUNIKATË PËR OPINIONIN PUBLIK**

12 Dhjetor 2022
Prishtinë

Në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit për Parandalimin dhe Sanksionimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive, të mbajtur sot (12 Dhjetor), anëtarët e Këshillit i kanë trajtuar me seriozitetin dhe urgjencën maksimale incidentet e shkaktuara në ndeshjen e zhvilluar në kuadër të Superkupës së Basketbollit të Kosovës ndërmjet K.B. Prishtina dhe K.B. Trepça, si edhe incidentet e shkaktuara në ndeshjen paraprake të Superkupës ndërmjet K.B. Bashkimi dhe K.B. Peja.

Këshilli për Sport shpreh indinjatën e thellë dhe i dënon rëndë incidentet e shkaktuara nga pjesëtarët e grupeve të tifozëve që identifikohen si: "Plisat" nga Prishtina, "Torcida" nga Mitrovica, "Arpagjikët" nga Prizreni dhe "Shqiponjat" nga Peja, si edhe kërkon nga të gjitha organet ligj-zbatuese që të ndërmarrin urgjentisht të gjitha veprimet përkatëse ligjore për identifikimin e personave që kanë kryer vepra të kundërligjshme dhe të marrin masat përkatëse për dënimin e tyre.

Njëkohësisht, Këshilli për Sport e dënon ashpër sulmin e shkaktuar nga huliganët ndaj katër zyrtarëve të Policisë së Kosovë, të cilët pësuan lëndime trupore gjatë kryerjes së detyrës zyrtare, si edhe ndaj qytetarëve që poashtu u lënduan nga personat e papërgjegjshëm, dhe të gjithëve iu uron shërim të shpejtë.

Për informim të opinionit të gjerë publik, anëtarët e Këshillit për Sport janë angazhuar që prej mbrëmë në funksion të adresimit adekuat të incidenteve të shkaktuara nga

huliganët, ndërsa që jemi njoftuar se dy prokurorë nga Prokuroria e Prishtinës menjëherë kanë dalë në vendngjarje, të cilët bashkë me zyrtarët e Policisë së Kosovës janë duke punuar në vazhdimësi për identifikimin e personave që kanë shkaktuar incidentet e mbrëmshme, dhe së shpejti priten veprimet konkrete për vënien e tyre para përgjegjësisë ligjore.

Përveç dëmeve të shkaktuara nga veprimet e tilla huliganeske në aspektin e prishjes së imazhit të përgjithshëm të shtetit dhe institucioneve që përkrahin dhe organizojnë ngjarjet sportive, shkaktimit të veprave tjera kundërvajtëse dhe penale (sharjet në kor, hedhja e mjeteve piroteknike, pjesëmarrja në sulm fizik, etj.), janë shkaktuar edhe dëme të konsiderueshme materiale duke dëmtuar pronën publike të palestrës sportive, dhe personat keqbërës duhet të mbahen përgjegjës për të gjitha këto shkelje.

Pas shqyrtimit të rrethanave të përgjithshme dhe atyre specifike lidhur me incidentet e mbrëmshme, Këshilli ka hartuar kërkesat dhe rekomandimet vijuese:

1. Të ndalohet pjesëmarrja në mënyrë të organizuar dhe me çfarëdo shenje dalluese e të gjitha grupeve të tifozëve në ndeshjet e basketbollit, të cilat organizohen nga Federata e Basketbollit të Kosovës, deri në një njoftim tjetër;
2. Kërkohet nga të gjitha grupet e tifozëve të cilët deri më tani nuk janë regjistruar tek Departamenti i Organizatave Joqeveritare (DOJQ) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ta bëjnë këtë gjë në afatin më të shkurtër kohor, dhe pas regjistrimit ta deponojnë listën me emrat e kryesisë dhe emrat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të OJQ-së tek Drejtoria për Sport e Komunës përkatëse;
3. Kërkohet nga Federata e Basketbollit të Kosovës që të aplikojë me rigorozitetin maksimal të gjitha dispozitat normative përkatëse që janë në kuadër të Propozicioneve të Garave të FBK-së.
4. Kërkohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që ta përfshijë në planifikimin buxhetor për vitin 2023 vendosjen e sistemit të kamerave të sigurisë në të gjitha palestrat sportive, ndërsa në vazhdim të procesit vendosja e kamerave të sigurisë të bëhet edhe në të gjitha stadiumet e futbollit;

Me respekt,

**Besim Kelmendi**
Kryetar i Këshillit për Sport
Tel: +383 44 666 913 (edhe në Viber)
Email: keshillipersport@rks-gov.net
Web: https://mkrs-ks.org/?page=1,176